

Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit të Projekteve Ndërkombëtare dhe Zhvillimit Strategjik të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik " i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", i ndryshuar, ligjit nr.2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.141, datë 22.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.763, datë 12.12.2022 "Për caktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së AKCESK", i ndryshuar, urdhrit të Kryeministrit nr. 233, datë 20.12.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit të Projekteve Ndërkombëtare dhe Zhvillimit Strategjik të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Bashkërendon dhe ndërvepron punën me institucione apo organizma të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, me qëllim përmbushjen e angazhimeve të institucionit;
- Siguron hartimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe të planit të veprimit, si dhe drejton monitorimin e tyre;
- Siguron kryerjen e procesit për anëtarësimin e Autoritetit në forume/organizma ndërkombëtarë, sipas fushës së veprimit të Autoritetit;
- Siguron hartimin e listës së infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit dhe administron listën e pikave të kontaktit me to;
- Merr pjesë në grupe të ndryshme pune, komisione, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare duke përfaqësuar institucionin;
- Inicion dhe ndjek projekte të ndryshme në funksion të përmbushjes së detyrave;
- Menaxhon punën e punonjësve të drejtorisë përkatëse.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

KËRKESAT E POSAÇME

Arsimi: Niveli minimal i diplomës "Master Shkencor", në Shkenca Shoqërore/Ekonomike.

Përvoja: Të paktën 10 vjet përvojë pune, nga të cilat të paktën 5 vjet eksperiencë në fusha që lidhen me drejtimin dhe menaxhimin në profesion.

FUSHA E NJOHURIVE:

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Marrëdhëniet ndërkombëtare; realizimin e politikave të jashtme dhe programet të lidhura me këte fushë;
- Njohuri mbi legjislacionin e Nënshkrimit Elektronik/Sigurinë Kibernetike/Identifikimin e Elektronik dhe Shërbimeve të Besuara;
- Specialitetet brenda fushës së caktuar profesionale;

Aftësi për të:

- Integruar informacionin me politikat institucionale;
- Identifikuar dhe qartësuar çështje, e dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale;
- Analizuar, komunikuar, prezantuar, si dhe për të pranuar metoda dhe procedura të reja.
- Të ketë aftësi shumë të mira drejtimi (*leadershipi*), koordinimi, formulimi politikash, menaxhimi strategjik, aftësi analitike, komunikimi, negocimi.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

Çdo kandidat jo-kualifikues pas procesit të intervistës, ka të drejtë për ankim jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (II-1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 02.01.2024, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@cesk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.